



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA III

Sesioni IV

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 09.**

Prishtinë, më 12.07.2011 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Jasmina Živkovië, Jelena Bontië, Petar Miletië, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Munguan: Myzejene Selmani dhe Mufera Sinik

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Albert Kinolli, zëvendëskryetar i paër i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/ L- 28 për dizajnin industrial, me raportin e Komisionit funksionale për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë. Tregti dhe Industri, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/ L-029 për patenta, me raportin e Komisionit funksionale për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë. Tregti dhe Industri, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-26 për Markat Tregtare, me raportin e Komisionit funksionale për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë. Tregti dhe Industri, me amendamente.
6. Shqyrtimi i Projektligjit për Përdorim Civil të Eksplozivëve Nr. 04/ L-22, me raportin e Komisionit funksionale për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së , me amendamente.
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, me raportin e Komisionit funksionale për Buxhet dhe Financa, me amendamente.
8. Të ndryshme

Albert Kinolli - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Krzesuesi - konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluar.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 5.07.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/ L- 28 për dizajnin industrial, me raportin e Komisionit funksionale për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë. Tregti dhe Industri, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/ L- 28 për dizajnin industrial, të propozuara nga Komisioni Funksional. Kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/ L- 28 për dizajnin industrial, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/ L-029 për patenta, me raportin e Komisionit funksionale për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë. Tregti dhe Industri, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/ L-029 për patenta, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/ L-029 për patenta, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-26 për Markat Tregtare, me raportin e Komisionit funksionale për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë. Tregti dhe Industri, me amendamente.

Kryesuesi paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-26 për Markat Tregtare, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-26 për Markat Tregtare, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Përdorim Civil të Eksplozivëve Nr. 04/ L-22, me raportin e Komisionit funksionale për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së , me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për përdorim Civil të Eksplozivëve Nr. 04/ L-22, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për përdorim Civil të Eksplozivëve Nr. 04/ L-22, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, me raportin e Komisionit funksionale për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për nr. 04/L- 014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L- 014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit

8. Të ndryshme

Jelena Bontic- e njoftoi komisioni se grupi parlamentar i SLS nxori vendim lidhur me emërimin e kryetarit Goran Marinkovic në vend të kryetarit Sasa Rasic si kryetar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Kryesuesi- njoftoi Komisionin se në takimin me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, dr.

Jakup Krasniqi, është shqyrtuar vetëm një pikë e rendit të ditës, përshpejtimi i procedimit të Projektligjeve që janë në shqyrtim në komisionet funksionale. Në periudhë të afërt do të vijnë edhe tetë projektligje nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kryetari i Kuvendit ka propozuar që të punohet edhe gjatë muajit gusht për arsye të miratimit të projektligjeve dhe për arsye të Raportit të progresit, Ai ka kërkuar që lidhur me këtë çështje të deklarohen të gjitha grupet parlamentare dhe se e njëjta pikë do të votohet ditën e enjte në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetar i dytë i Komisionit

Albert Kinolli